



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 102 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 24 / 10 / 2022

VENDIM

Nr.25, date 24 /10/2022

PËR

PROJEKTIN E ZBATIMIT PER REHABILITIMIN E DIGES SE PACOMIT, PERMET

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 24.10.2022 mori në shqyrtim Projektin e rishikuar të Zbatimit të punimeve për rehabilitimin e diges së Pacomit të paraqitur nga Bashkia Permet. Dokumentacioni teknik i projektit të zbatimit të dorëzuar pranë SKDM ka përfshirë kërkesat e KKDM të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 19, dt.21.07.2022 në lidhje me llogaritjet e qëndrueshmërisë së digës, matjet batimetrike të volumeve aktuale të ujit në rezervuar dhe kurbat e volumeve dhe të sipërfaqes së ujit në Rezervuar deri në kuotën maksimale të uji, analizen e filtrimeve në anën e poshtme të diges si dhe instalimin e instrumentave të monitorimit gjeodezik dhe hidraulik të diges. Njekohesisht, u theksua fakti se në këtë dokumentacion mungojnë Rregullorja e shfrytëzimit, operimit, monitorimit dhe sigurisë së digës, Plani i gadishmërisë në rastet e emergjencave civile si dhe vlerësimi i aseteve të digës dhe strukturave të saj.

Projekti është i shoqëruar edhe me Oponencën e një firme konsulente të licencuar e cila ka arritur në konkluzionin se Projekti i plotëson kushtet teknike për zbatimin e tij.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Projektin e rishikuar të Zbatimit për Rehabilitimin e digës së Pacomit të paraqitur nga Bashkia Permet.
- 2- Ti kërkojë Bashkisë Përmet:
 - Të informoj KKDM për fillimin e punimeve dhe caktimin e Mbikqyresit të punimeve sipas kërkesave të VKM së mesiperme, neni 20 dhe neni 21;
 - Bazuar në rezultatet e këtij projekti në lidhje me hartën e permbytjeve dhe banoret që janë në rrezik në zonën urbane poshtë diges, të përgatit dhe të dorëzohet pranë KKDM Planin e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me hartën e permbytjes dhe skenarët e rrezikut dhe të dhënies së alarmit. Bashkia Permet duhet të parashikojë sa më shpejt të jete e mundur hartimin e një projekti për instalimin e një sistemi alarmi në dige dhe në zonën urbane poshtë saj;
 - Të kryejë, Uljen e niveleve të ujit në rezervuar sipas udhëzimeve të dhëna nga KKDM dhe legjislacioni në fuqi
 - Të mos lejoj përdorimin e minave të vogla në rrugën hyrëse për në Dige
 - Ti kërkoj Kontraktorit të punimeve prezencën e një gjeologu gjatë zbatimit të punimeve i cili duhet të kryejë testet dhe të përgatit një Raport me shkrim ku të jepet rezultatet e tyre dhe karakteristikat e materialit mbushës ekzistues dhe materialit të ri që do të përdoret;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Pas përfundimit të punimeve dhe instalimit të sistemeve të monitorimit në dige, të përgatit dhe të dorëzohet pranë KKDM rregulloren e shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digës sipas Nenit 29 të VKM së mësipërme dhe Vendimit të KKDM Nr.3, datë 09.10.2020 “Udhëzues i përgjithshëm për hartimin e rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave”
- Brenda vitit 2022 të dorëzohet pranë KKDM një Raport në lidhje me Vlerësimin e aseteve të digave që administrohen nga Bashkia Përmet duke përfshirë edhe vlerën e këtyre aseteve deri në fund të vitit 2021.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

